L I G J
Nr.9604, datë 11.9.2006

PËR RATIFIKIMIN E "KONVENTËS SË BASHKËPUNIMIT POLICOR PËR EUROPËN JUGLINDORE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Konventa e bashkëpunimit policor për Europën Juglindore".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5054, datë 4.10.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA E BASHKËPUNIMIT POLICOR PËR EUROPËN JUGLINDORE
Versioni përfundimtar 31.3.06

Hyrje

Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Maqedonisë, Republika e Moldavisë, Rumania dhe Unioni Shtetëror i Serbisë dhe Malit të Zi,

në vijim të quajtura si "Palët Kontraktuese",

- *me dëshirën* për të bashkëpunuar për përmbushjen e interesave të përbashkëta të sigurisë;
- *të vendosura* për të luftuar me efikasitet kërcënimet ndërkufitare ndaj rendit dhe sigurisë publike si dhe krimin ndërkombëtar, duke hyrë në një partneritet për sigurinë;
- *duke synuar* rritjen dhe intensifikimin e mëtejshëm të bashkëpunimit policor;
- *të vendosura* për të fuqizuar mbështetjen reciproke në çështjet policore;
- janë dakord për sa vijon:

Neni 1
Fusha e kësaj Konvente

Palët Kontraktuese do të forcojnë bashkëpunimin ndërmjet tyre në lidhje me luftën kundër kërcënimeve ndaj sigurisë publike dhe/ose rendit, si dhe parandalimin, zbulimin dhe hetimin policor të veprave penale. Kjo realizohet duke zbatuar ligjin kombëtar, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë Konventë.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllim të kësaj Konvente:

-"Autoritetet e zbatimit të ligjit" nënkuptojnë autoritetet, të cilat në përputhje me ligjin kombëtar të Palëve Kontraktuese, kanë kompetencën e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente.

- "Zyrtarët" nënkupton çdo individ të caktuar nga autoritetet e zbatimit të ligjit.

- "Kufijtë" nënkuptojnë kufijtë tokësorë, ujorë të Palëve Kontraktuese, aeroportet dhe portet e

tyre detare, të përcaktuara sipas ligjit kombëtar dhe të pranuara në nivel ndërkombëtar.

- “Shtet i tretë” nënkupton çdo shtet tjetër përveç Palëve Kontraktuese.

- “Leje qëndrimi” nënkupton një autorizim i çfarëdolloji i lëshuar nga një Palë Kontraktuese, i cili i jep të drejtën e qëndrimit brenda territorit të saj. Ky përkufizim nuk përfshin lejen e përkohshme për të qëndruar në territorin e një Pale Kontraktuese me qëllim përpunimin e një aplikimi për azil apo për një leje qëndrimi.

- “Të dhëna personale” nënkupton çdo të dhënë që ka lidhje me një person fizik të identifikuar apo të identifikueshëm: një person i identifikueshëm është një person që mund të identifikohet, në mënyrë direkte apo indirekte, sidomos duke iu referuar një numri identifikimi apo një ose më shumë faktorëve specifikë të identitetit të tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

- “Përpunimi i të dhënave personale” (që në vijim do të referohet si “përpunimi”) nënkupton çdo operacion apo kompleks operacionesh që kryhet mbi të dhënat personale, me ose pa mjete të automatizuara, si p.sh. mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, adaptimi apo ndryshimi, korrigjimi, konsultimi, përdorimi, ekspozimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarjes ose me fjalë të tjera vënia në dispozicion, lidhja apo kombinimi, bllokimi, fshirja apo asgjësimi.

- “Informacioni” nënkupton të dhëna personale dhe jopersonale.

Neni 3

Masa të përgjithshme të bashkëpunimit

Autoritetet e zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese do të marrin të gjitha masat brenda juridiksionit të tyre me synim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre.

- Në veçanti, autoritetet angazhohen për:

1. Rritjen e shkëmbimit të informacionit dhe strukturave të komunikimit nëpërmjet:

- informimit të njëri-tjetrit mbi faktet e çështjeve, lidhjet ndërmjet të dyshuarve dhe sjelljes tipike të të dyshuarit, pa përmendur të dhëna në lidhje me personin;

- informimit të njëri-tjetrit në mënyrë të drejtpërdrejtë, sa më në kohë që të jetë e mundur, për ngjarje dhe incidente të pritshme me interes për policinë, pa përmendur të dhëna që kanë lidhje me personin, për të ndihmuar në luftën kundër kërcënimeve ndaj rendit dhe sigurisë publike, në mënyrë që të mund të merren në kohë masat e nevojshme;

- shkëmbimit të informacionit të rëndësishëm, përveç të dhënave në lidhje me personin, për të ndihmuar në planifikimin operacional, si për aktivitetet rutinë ashtu edhe për operacionet speciale, duke përfshirë – si një masë paraprake – informacione sekrete rreth ngjarjeve dhe incidenteve që mund të kenë ndikim në territorin e Palës tjetër Kontraktuese respektive;

- përgatitjes dhe azhurnimit në mënyrë të rregullt të listave të përbashkëta që përmbajnë të dhëna rreth juridiksionit dhe kompetencave, të dhënave të kontaktit;

- mbajtjes së komunikimit me radio duke shkëmbyer pajisjet deri në prezantimin e një pajisjeje uniforme radioje dhe frekuencash për të gjitha vendet e Europës, dhe përgatitjes së propozimeve të përbashkëta për përmirësimin e telekomunikacionit me kosto të ulët, sidomos komunikimit me radio përgjatë kufijve.

2. Forcimin e bashkëpunimit gjatë operacioneve dhe hetimeve me qëllim parandalimin, zbulimin dhe hetimin dhe për të luftuar kundër kërcënimeve:

- duke vendosur forcat në zonat kufitare fqinje në përputhje me një planifikim të koordinuar;

- duke planifikuar dhe realizuar programe të përbashkëta në fushën e parandalimit të krimit;

- duke zhvilluar takime dhe bisedime në intervale kohore të rregullta në mënyrë që të mbahet nën kontroll dhe të ruhet cilësia e bashkëpunimit, të diskutohen strategji të reja, të koordinohen planet e patrullimit, kërkimit dhe operacioneve, të shkëmbehen të dhëna statistikore dhe të koordinohen programet e punës;

- duke lehtësuar vizitat e ndërsjella studimore/trajnuese sipas marrëveshjeve të departamenteve të interesuara;

- duke ftuar përfaqësues të Palëve të tjera Kontraktuese për të marrë pjesë në operacionet speciale si vëzhgues.

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 4
Bashkëpunimi sipas kërkesës

1. Autoritetet e zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese, sipas kërkesës, duhet të japin asistencë reciproke brenda kuadrit të juridiksioneve të tyre respektive për të marrë masa kundër kërcënimeve ndaj rendit dhe/ose sigurisë publike[1], dhe për të parandaluar, zbuluar dhe hetuar veprat penale, përveç rasteve kur një kërkesë e tillë apo ekzekutimi i saj, mund të trajtohet vetëm nga autoritetet e drejtësisë sipas ligjeve në fuqi të vendit në fjalë. Në qoftë se autoriteti, të cilit i drejtohet kërkesa, nuk është kompetent për të trajtuar këtë kërkesë, ai duhet t'ia kalojë kërkesën autoritetit kompetent dhe të informojë në të njëjtën kohë autoritetin që ka dërguar kërkesën.

2. Autoritetet e zbatimit të ligjit, me kuptimin që kanë në këtë Konventë, janë të përmendura në listat e bashkëngjitura. Në çdo rast, nuk mund të ndërhyhet te kompetencat e ministrive të tjera.

3. Palët Kontraktuese do të krijojnë ose emërojnë Njësitë Qendrore Kombëtare. Strukturat ekzistuese në vendet respektive do të përdoren deri në krijimin ose emërimin e Njësive Qendrore Kombëtare.

4. Kërkesat dhe përgjigjet ndaj këtyre kërkesave, në rast se bashkëpunimi direkt duket se është i përshtatshëm, mund të shkëmbehen ndërmjet autoriteteve të përcaktuara në listat e bashkëngjitura, duke informuar Njësinë Qendrore Kombëtare ose strukturat ekzistuese për një procedurë të tillë:

a) në rast se aktivitetet ndërkufitare i referohen veprave penale, të cilat sipas të gjitha gjasave do të hetohen nga autoritetet e zbatimit të ligjit të rajonit kufitar, ose

b) në rast se kërkesat për të ndihmuar në mënjanimin e kërcënimeve të pritshme ndaj rendit dhe/ose sigurisë publike nuk mund të transmetohen në rrugë të tjera në kohë nëpërmjet kanaleve të zakonshme të Njësive Qendrore Kombëtare.

5. Kërkesat, në mënyrë specifike, mund të përmbajnë:

a) identifikimin e pronarëve dhe përdoruesve të automjeteve, të gjitha llojeve të mjeteve lundruese dhe avionëve;

- Me kërkesën e njërës prej Palëve Kontraktuese, Pala Kontraktuese së cilës i drejtohet kërkesa duhet t'i transmetojë të dhënat e disponueshme në lidhje me automjetet, të gjitha llojet e mjeteve lundruese dhe avionëve, si dhe të dhënat për pronarët dhe përdoruesit, në rast se këto të dhëna janë të nevojshme për të identifikuar një person në cilësinë e tij/saj si pronar/përdorues i mjetit në fjalë, ose për të identifikuar automjetet e përdorura nga një person, ose të dhënat e automjetit që kërkohen, për të parandaluar dhe luftuar kundër veprave kriminale, si dhe për mbrojtjen e rendit dhe/ose sigurisë publike nga kërcënimet.

- Autoritetet e zbatimit të ligjit të Palës Kontraktuese që bën kërkesën mund t'ia adresojnë kërkesën autoritetit (autoriteteve) i cili (të cilat) mban/ruan (mbajnë/ruajnë) programin e të dhënave të regjistrimit të automjeteve, ose në raste urgjente, në të njëjtën mënyrë, nëse kërkohet informacion nga autoritetet respektive për numrat e regjistrimit të të gjitha llojeve të mjeteve lundruese, ia adresojnë kërkesën një autoriteti të zbatimit të ligjit të Palës Kontraktuese së cilës i drejtohet kërkesa.

b) informacion mbi dokumentet e automjeteve dhe dëshmive të aftësisë për drejtim automjeti (patentat), si dhe dokumenteve dhe lejeve të qarkullimit të krahasueshme;

c) përcaktimin e vendbanimit, vendqëndrimit dhe lejeve të qëndrimit;

d) identifikimin e abonentëve telefonikë ose të pajisjeve të tjera të telekomunikacionit;

e) identifikimin e individëve, trupave pa jetë apo pjesëve të trupave pa jetë;

f) informacion mbi origjinën e sendeve, si p.sh. armëve të zjarrit, municioneve dhe eksplozivëve, pajisjeve eksplozive, automjeteve, të gjitha llojeve të mjeteve lundruese dhe avionëve, si dhe pasurisë kulturore;

g) kërkimin e pasurive dhe personave në kërkim;

h) fillimin dhe koordinimin e masave kërkuese;

i) intervistat dhe marrjet në pyetje nga ana e policisë, sidomos duke përcaktuar vullnetin e

[1] Kërcënim për rendin publik dhe/ose sigurinë mund të konsiderohet gjithashtu në lidhje me kondëvajtjet dhe çështjet administrative në juridiksionet respektive të autoriteteve të zbatimit të ligjit.

personit për të dhënë informacion;

j) informacion mbi hetimin në vendngjarje, mbledhjen e provave, vlerësimin dhe analizën e tyre;

k) masat konkrete për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarit;

l) shkëmbimin e informacionit në rastet e ndjekjes në gjendjen e flagrancës;

m) bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit për kontrollin e turmës në të gjitha rastet e grumbullimeve publike.

6. Kërkesat dhe përgjigjet ndaj këtyre kërkesave do të bëhen me shkrim (ose me faks, apo e-mail). Në rast se transmetohen të dhëna për personin, duhet të zgjidhet patjetër një metodë e sigurt transmetimi, gjithnjë duke mbajtur parasysh sensitivitetin e të dhënave. Në rastet urgjente, kërkesat mund të bëhen me gojë, megjithatë, menjëherë më pas duhet bërë një konfirmim me shkrim. Përgjigjja me shkrim do të jepet vetëm pasi të jetë marrë konfirmimi me shkrim. Palët Kontraktuese duhet të sigurojnë që vetëm personeli i autorizuar të ketë të drejtën të përdorë mjetet e komunikimit.

Neni 5

Sfera e informacioneve që shkëmbehen

1. Gjatë bashkëpunimit, duke synuar parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale, në veçanti krimin e organizuar, autoritetet e Palëve Kontraktuese, mbi bazën e kërkesës, do të shkëmbejnë informacionin e mëposhtëm:

a) Mbi të dhënat e individëve të përfshirë në krimin e organizuar, të dhënat për lidhjet ndërmjet të dyshuarve dhe personave për të cilët ka dyshime në lidhje me kryerjen e veprave penale, njohuritë e tyre për strukturën e grupeve dhe organizatave kriminale, mbi modelet e sjelljes tipike të të dyshuarve dhe personave për të cilët ka dyshime apo të grupeve të dyshuara dhe grupeve për të cilët ka dyshime, informacion mbi veprat penale të përgatitura, në tentativë apo të kryera, sidomos për kohën, vendngjarjen dhe llojin e krimit, detaje mbi viktimat apo pronën e dëmtuar, të dhëna mbi rrethanat e veçanta dhe mbi dispozitat ligjore përkatëse, në rast se kërkohet të parandalohen, zbulohen dhe hetohen veprat penale;

b) Mbi metodat dhe format e reja të krimit ndërkufitar;

c) Mbi rezultatet kërkimore në lidhje me krimin dhe kriminologjinë, detaje mbi praktikën e zhvillimit të hetimeve, metodat dhe mjetet e punës, me synim zhvillimin e tyre të mëtejshëm;

d) Mbi të dhënat e përpunuara dhe/ose kampionet (mostrat) e sendeve apo pronës që janë dëmtuar gjatë veprës penale, ose që janë përdorur apo tentuar të përdoren për kryerjen e një vepre penale, ose që kanë qenë rezultat i një vepre penale të kryer;

e) Mbi legjislacionin në fuqi që ka të bëjë me krimet që janë objekt i kësaj Konvente;

f) Mbi produktet kriminale dhe asetet të përfituara nëpërmjet kryerjes apo përfshirjes në krim.

2. Kur merret informacion nëpërmjet metodave speciale, autoritetet e Palëve Kontraktuese duhet të bashkëpunojnë në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar. Palët Kontraktuese angazhohen të sigurojnë të paktën të njëjtin standard të ruajtjes së të dhënave që transmetohen gjatë shkëmbimeve të tilla të informacionit siç përshkruhet nga dispozitat ligjore kombëtare respektive.

Neni 6

Shkëmbimi i informacionit pa kërkesë

Në raste të veçanta, autoritetet e zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacion me njëri-tjetrin edhe pa pasur një kërkesë, në qoftë se, bazuar në fakte të provuara, ka arsye të besohet se një informacion i tillë është i nevojshëm për të eliminuar kërcënime konkrete ndaj rendit dhe/ose sigurisë publike, ose për të parandaluar, zbuluar dhe hetuar vepra penale. Përsa i përket shkëmbimit të informacionit, neni 4 paragrafët 3 (Njësitë Qendrore Kombëtare), 4 (kërkesat dhe përgjigjet ndaj këtyre kërkesave), dhe 6 (kërkesat me shkrim nëpërmjet faksit ose e-mail-it) do të aplikohen respektivisht.

Neni 7

Analiza e përbashkët e rrezikut

Autoritetet e zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese duhet të aspirojnë të kenë një nivel uniform të informacionit mbi situatën e shkallës së kriminalitetit, për aq sa kjo të jetë e mundur. Për këtë qëllim, ato duhet të shkëmbejnë raportet mbi gjendjen e kriminalitetit në mënyrë periodike, ose në rast se lind nevoja, do të organizojnë analiza të përbashkëta, të paktën një herë në vit.

Neni 8

Shkëmbimi i rregullt i informacionit për të luftuar migracionin ilegal

1. Palët Kontraktuese do të shkëmbejnë informacione në mënyrë të rregullt për të luftuar kalimet e paligjshme të kufirit dhe trafikimin e qenieve njerëzore.

2. Informacioni që duhet shkëmbyer, në radhë të parë duhet t'i referohet lëvizjeve të migracionit, shtrirjes, strukturës dhe destinacioneve të mundshme, si dhe rrugëve të mundshme të migracionit dhe mjeteve të transportit që përdoren për të kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin, si dhe mënyrën e organizimit të trafikantëve. Për më tepër, do të komunikohen informacione dhe analiza që i referohen situatës aktuale, si dhe masat e planifikuara që mund të jenë të dobishme për Palën tjetër Kontraktuese.

Neni 9

Oficerët e kontaktit

1. Palët Kontraktuese mund të përfundojnë marrëveshje dypalëshe duke mundësuar atashimin e oficerëve të kontaktit, për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohore, nga një Palë Kontraktuese tek autoritetet e zbatimit të ligjit të një Pale tjetër Kontraktuese.

2. Atashimi i oficerëve të kontaktit për një periudhë kohore të caktuar ose të pacaktuar bëhet me qëllim rritjen dhe përshpejtimin e bashkëpunimit ndërmjet Palëve Kontraktuese, sidomos duke dhënë asistencë:

a) në formë të shkëmbimit të informacionit për qëllime të kësaj Konvente;

b) në ekzekutimin e kërkesave për asistencë reciproke policore në çështje penale;

c) në lidhje me detyrat e kryera nga autoritetet përgjegjëse për survejimin e kufirit.

3. Oficerët e kontaktit do të kenë për detyrë të japin këshilla dhe asistencë. Ata nuk do të kenë kompetencë të ndërmarrin veprime policore të pavarura. Ata do të japin informacione dhe do të kryejnë detyrat e tyre në përputhje me udhëzimet që u janë dhënë nga Pala Kontraktuese që i ka emëruar dhe nga Pala Kontraktuese ku janë atashuar.

4. Palët Kontraktuese mund të bien dakord brenda një kuadri të marrëveshjes dypalëshe, ose një marrëveshjeje shumëpalëshe, që oficerët e kontaktit të një Pale Kontraktuese të atashuar në shtete të treta, do të përfaqësojnë gjithashtu interesat e një ose më shumë Palëve të tjera Kontraktuese. Në bazë të marrëveshjeve të tilla, oficerët e kontaktit të atashuar në shtete të treta do t'u japin informacion Palëve të tjera Kontraktuese kur një gjë e tillë u kërkohet, ose me iniciativën e tyre, dhe duhet të kryejnë detyrat për llogari të këtyre Palëve brenda kufijve të kompetencave të tyre. Palët Kontraktuese do të informojnë njëra-tjetrën për qëllimet e tyre në lidhje me atashimin e oficerëve të kontaktit në shtete të treta.

Neni 10

Mbrojtja e dëshmitarit

1. Autoritetet e zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese përgjegjëse për mbrojtjen e dëshmitarit duhet të bashkëpunojnë në mënyrë direkte në fushën e programeve të mbrojtjes së dëshmitarit.

2. Në mënyrë të veçantë, bashkëpunimi do të përfshijë shkëmbimin e informacionit, asistencën përsa i takon logjistikës, dhe marrjen në dorëzim të personave që duhen marrë nën mbrojtje.

3. Për secilin rast të marrjes në dorëzim të personave që duhet marrë nën mbrojtje do të nënshkruhet një marrëveshje, në mënyrë që të rregullohen të drejtat dhe detyrimet reciproke.

4. Personi që do të merret nën mbrojtje duhen patjetër të jetë përfshirë në programin e mbrojtjes së dëshmitarit të Palës Kontraktuese që ka bërë kërkesën. Personi që duhet marrë nën mbrojtje nuk do të përfshihet në programin e mbrojtjes së dëshmitarit të Palës Kontraktuese, së cilës i

drejtohet kërkesa. Kur merren masa mbështetëse në lidhje me mbrojtjen e këtyre personave, do të aplikohet legjislacioni përkatës i Palës Kontraktuese së cilës i drejtohet kërkesa.

5. Në parim, Pala Kontraktuese që bën kërkesën do të mbulojë shpenzimet e jetesës për personat që janë marrë nën mbrojtje. Pala Kontraktuese së cilës i është drejtuar kërkesa do të mbulojë shpenzimet për burimet materiale dhe të personelit që duhen për mbrojtjen e këtyre personave.

6. Pala Kontraktuese së cilës i drejtohet kërkesa mund t'u japë fund masave mbështetëse që ka ofruar në qoftë se ka arsye të forta dhe pasi ka njoftuar në mënyrën e duhur Palën Kontraktuese që ka bërë kërkesën. Në këtë rast, Pala Kontraktuese që ka bërë kërkesën, do ta rimarrë personin në fjalë.

Neni 11

Trajnimi bazë dhe i përparuar, si dhe shkëmbimi i eksperiencës

Autoritetet e zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese duhet të bashkëpunojnë në fushën e trajnimit bazë dhe të përparuar, në mënyrë të ndërsjellë nëpërmjet:

a) shkëmbimit të programeve mësimore për trajnimin bazë dhe të përparuar;

b) organizimit të seminareve të përbashkëta për trajnimin bazë dhe të përparuar, si dhe ushtrimeve stërvitore ndërkufitare si pjesë e bashkëpunimit të përcaktuar në këtë Konventë;

c) ftesës për përfaqësuesit e autoriteteve të zbatimit të ligjit të Palës tjetër Kontraktuese për të marrë pjesë në ushtrimet stërvitore dhe operacionet speciale si vëzhgues, si dhe marrjen e masave për zhvillimin e vizitave trajnuese praktike reciproke;

d) lejimit të përfaqësuesve të autoriteteve të zbatimit të ligjit të Palës tjetër Kontraktuese për të marrë pjesë në kurset e trajnimit të përparuar.

Neni 12

Parandalimi

Autoritetet e zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese duhet të shkëmbejnë eksperiencë në fushën e parandalimit të krimit, të fillojnë dhe të zbatojnë programe për këtë qëllim.

Neni 13

Ndjekja në gjendjen e flagrancës

1. Oficerët e njërës prej Palëve Kontraktuese, që janë në ndjekje brenda territorit të vendit të tyre të një individi të kapur në aktin e kryerjes apo pjesëmarrjes në një vepër penale, duhet të lejohen të vazhdojnë ndjekjen në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese pa pasur autorizimin paraprak të kësaj të fundit në bazë të marrëveshjeve bilaterale të zbatimit, të përfunduara në përputhje me nenin 34, paragrafi 1 i kësaj Konvente, kur për shkak të urgjencës së situatës nuk është e mundur të njoftohen autoritetet kompetente të Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet njërës prej rrugëve të shtjelluara në nenin 24 të Konventës përpara hyrjes në territorin e këtij vendi, ose kur këto autoritete nuk kanë mundësi të arrijnë në kohë në vendngjarje për të marrë përsipër përgjegjësinë e ndjekjes.

E njëjta gjë do të aplikohet në rast se personi në ndjekje është arratisur nga ambientet e paraburgimit ose ndërkohë që vuante dënimin me heqje të lirisë.

Oficerët që janë në ndjekje, duhet të kontaktojnë me autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës po kryhet ndjekja në gjendjen e flagrancës jo më vonë sesa kur kalojnë kufirin. Ndjekja në gjendjen e flagrancës duhet të përfundojë menjëherë sapo Pala Kontraktuese në territorin e së cilës po kryhet ndjekja do ta kërkojë një gjë të tillë. Me kërkesë të oficerëve që janë në ndjekje, autoritetet lokale kompetente do të marrin masat për identifikimin ose arrestimin e personit në ndjekje.

2. Marrëveshjet dypalëshe të zbatimit të referuara në paragrafin 1 të këtij neni duhet të përcaktojnë veprat penale për të cilat do të zbatohet ndjekja në gjendjen e flagrancës ose me anë të një liste të detajuar ose duke përfshirë të gjitha veprat penale, për të cilat autorët e tyre ekstradohen.

3. Ndjekja në gjendjen e flagrancës duhet të kryhet në përputhje me njërën nga procedurat e mëposhtme, të përcaktuara nga marrëveshjet dypalëshe të zbatimit të referuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni:

a) Oficerët që marrin pjesë në ndjekje nuk kanë të drejtën të arrestojnë personin në ndjekje;

b) Në qoftë se nuk bëhet kërkesë për ta ndaluar ndjekjen në gjendjen e flagrancës, dhe në qoftë se autoritetet lokale kompetente nuk janë në gjendje të ndërhyjnë me shpejtësinë e duhur, oficerët që marrin pjesë në ndjekje mund ta ndalojnë personin që po ndiqet, derisa oficerët e Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës po kryhet ndjekja, të cilët duhen medoemos të informohen menjëherë, të jenë në gjendje të përcaktojnë identitetin e personit ose të bëjnë arrestimin e tij.

4. Ndjekja në gjendjen e flagrancës do të kryhet në përputhje me paragrafët 1 dhe 3 dhe në një nga mënyrat e mëposhtme të përcaktuara në Marrëveshjet dypalëshe të zbatimit, të referuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni:

a) Në një zonë ose gjatë një periudhe që nga kalimi i kufirit, që do të përcaktohet në Marrëveshjen dypalëshe të zbatimit;

b) Pa kufizime në hapësirë dhe kohë.

5. Ndjekja në gjendjen e flagrancës do të kryhet vetëm sipas kushteve të përgjithshme të mëposhtme:

a) Oficerët që po kryejnë ndjekjen duhet patjetër të veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij neni si dhe të ligjit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës po operojnë; ata duhet patjetër të zbatojnë udhëzimet e lëshuara nga autoritetet lokale kompetente.

b) Ndjekja do të bëhet vetëm në kufijtë tokësorë dhe në kufijtë blu.

c) Është e ndaluar hyrja në banesa private dhe vende ku publiku nuk ka të drejtë të hyjë.

d) Oficerët që kryejnë ndjekjen duhet të jenë lehtësisht të dallueshëm, qoftë nëpërmjet uniformës së tyre, ose nëpërmjet shenjave dalluese në krah apo automjetet e tyre; përdorimi i veshjeve civile i kombinuar me automjete pa shenja identifikuese të përmendura më sipër nuk është i lejuar; oficerët që kryejnë ndjekjen duhet që gjatë gjithë kohës të jenë në gjendje të provojnë se ata janë duke vepruar në cilësinë e një përfaqësuesi zyrtar.

e) Oficerët që kryejnë ndjekjen mund të mbajnë armët e tyre të shërbimit; përdorimi i tyre nuk lejohet, me përjashtim të rasteve të vetëmbrojtjes së ligjshme.

f) Menjëherë pasi personi që ndiqet të jetë ndaluar siç parashikohet në paragrafin 3(b), me qëllim të dërgimit të tij përpara autoriteteve lokale kompetente, ky person mund t'i nënshtrohet vetëm një kontrolli sigurie; prangat mund të përdoren gjatë transferimit; gjithashtu mund të sekuestrohen edhe sendet që mban ky person.

g) Pas çdo operacioni të referuar në paragrafët 1, 3 dhe 4, oficerët që marrin pjesë në ndjekje duhet të paraqiten përpara autoriteteve lokale kompetente të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ata kanë operuar dhe duhet të raportojnë mbi misionin e tyre; me kërkesë të këtyre autoriteteve, ata duhet të qëndrojnë në dispozicion të tyre deri në sqarimin në shkallë të mjaftueshme të rrethanave që kanë çuar në këtë veprim; ky kusht duhet të aplikohet edhe në rast se ndjekja në gjendjen e flagrancës nuk ka rezultuar në arrestimin e personit të ndjekur.

h) Kur u kërkohet nga autoritetet e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës është kryer ndjekja në gjendjen e flagrancës, autoritetet e Palës Kontraktuese nga kanë ardhur oficerët që kanë kryer ndjekjen, duhet të asistojnë në hetimet pas operacionit në të cilin ata kanë marrë pjesë, përfshirë këtu edhe procesin gjyqësor, me kusht që të mbrohet identiteti i oficerëve të përfshirë në ndjekje.

6. Një person i cili, në vijim të veprimit të parashikuar në paragrafin 3, është arrestuar nga autoritetet lokale kompetente mund, pavarësisht nga shtetësia e personit, të mbahet për t'u marrë në pyetje. Rregullat përkatëse të ligjit të vendit duhet të zbatohen rast pas rasti.

Në qoftë se personi nuk është shtetas i Palës Kontraktuese në territorin e të cilës ky person është arrestuar, atëherë ky person duhet të lihet i lirë jo më vonë se 6 orë nga momenti kur është bërë arrestimi, duke mos përfshirë këtu orët nga mesnata deri në orën 09:00 të mëngjesit, në qoftë se autoritetet lokale kompetente nuk kanë marrë paraprakisht një kërkesë për arrest të përkohshëm të këtij personi, me qëllim ekstradimin e tij në një prej formave të mundshme.

7. Oficerët e referuar në paragrafët e mësipërme duhet të përmenden në marrëveshjet dypalëshe të zbatimit.

8. Bazuar në marrëveshje dypalëshe, Palët Kontraktuese mund të zgjerojnë fushëveprimin e paragrafit 1 dhe mund të adoptojnë dispozita shtesë në zbatim të këtij neni.

Neni 14

Survejimi ndërkufitar

1. Oficerët e njërës prej Palëve Kontraktuese, të cilët, si pjesë e një hetimi penal, mbajnë nën survejim në vendin e tyre një person që prezumohet të ketë marrë pjesë në një vepër penale të ekstradueshme, duhet të autorizohen të vazhdojnë survejimin e tyre në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese në bazë të Marrëveshjeve dypalëshe të zbatimit të përfunduara në përputhje me nenin 34 paragrafi 1 të kësaj Konvente, në ato raste kur kjo e fundit ka autorizuar survejimin ndërkufitar në përgjigje të një kërkese të bërë që më parë. Këtij autorizimi mund t'i bashkëngjiten kushte. Sipas kërkesës, survejimi do t'u besohet oficerëve të Palës Kontraktuese në territorin e të cilës kryhet ky survejim. Kërkesa për asistencë, referuar në nënparagrafin e parë, duhet të dërgohet tek një autoritet që është caktuar nga secila Palë Kontraktuese dhe që ka kompetencën të lëshojë apo të kalojë autorizimin e kërkuar.

2. Aty ku, për arsye urgjente të veçanta, kërkesa paraprake për autorizim nuk mund të dërgohet nga Pala Kontraktuese kërkuese, oficerët që bëjnë survejimin duhet të lejohen të vazhdojnë survejimin përtej kufirit të një personi të prezumuar se ka kryer një vepër penale siç përmendet në paragrafin 3, në bazë të marrëveshjeve dypalëshe të zbatimit, të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni. Në këto raste, duhet patjetër të njoftohet menjëherë për kalimin e kufirit autoriteti i Palës Kontraktuese në territorin e së cilës do të vazhdohet survejimi, dhe duhet të dërgohet pa vonesë një kërkesë për asistencë, duke theksuar arsyet për kalimin e kufirit pa pasur autorizimin paraprak.

3. Marrëveshjet dypalëshe të zbatimit, të referuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të përcaktojnë veprat penale të përmendura në paragrafin 2 ose nëpërmjet një liste të detajuar ose duke përfshirë të gjitha veprat penale, për të cilat autorët e tyre ekstradohen.

4. Survejimi duhet të ndërpritet menjëherë, nëse Pala Kontraktuese, në territorin e së cilës po kryhet survejimi, në vijim të njoftimit ose kërkesës së referuar në paragrafin e mësipërm, nuk ka lëshuar autorizimin 5 orë pasi është kaluar kufiri.

5. Survejimi, referuar në paragrafët 1 dhe 2, do të kryhet vetëm sipas kushteve të përgjithshme që vijojnë:

a) Oficerët që kryejnë survejimin duhet medoemos të veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij neni dhe të ligjit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ata operojnë; ata duhet të zbatojnë patjetër udhëzimet e autoriteteve lokale kompetente.

b) Përveç situatave të shtjelluara në paragrafin 2, gjatë survejimit oficerët duhet të mbajnë me vete një dokument që vërteton se është marrë autorizimi.

c) Oficerët që kryejnë survejimin duhet patjetër që në çdo kohë të jenë në gjendje të provojnë se janë duke vepruar në cilësinë e një përfaqësuesi zyrtar.

d) Oficerët që kryejnë survejimin mund të mbajnë me vete armët e tyre të shërbimit gjatë survejimit, në qoftë se nuk është vendosur në mënyrë specifike për të kundërtën nga Pala së cilës i drejtohet kërkesa; përdorimi i tyre ndalohet, me përjashtim të rasteve të vetëmbrojtjes legjitime.

e) Është e ndaluar hyrja në banesa private dhe vende ku publiku nuk ka të drejtë të hyjë.

f) Oficerët që kryejnë survejimin nuk mund as ta ndalojnë, dhe as ta arrestojnë personin nën survejim.

g) Të gjitha operacionet duhet të jenë objekt i një raporti për autoritetet e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ato janë zhvilluar; oficerëve që kryejnë survejimin mund t'u kërkohet të paraqiten vetë.

h) Kur kërkohet nga autoritetet e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës është kryer survejimi, autoritetet e Palës Kontraktuese nga kanë ardhur oficerët që kryejnë survejimin duhet të ndihmojnë hetimin që zhvillohet në vijim të operacionit të tyre, përfshirë këtu procesin gjyqësor, me kusht që të ruhet identiteti i oficerëve të përfshirë në operacion.

6. Oficerët e referuar në paragrafët e mësipërm duhet të përmenden në marrëveshjet dypalëshe të zbatimit.

7. Palët Kontraktuese mund ta zgjerojnë fushëveprimin e këtij neni dhe të adoptojnë masa shtesë të aplikueshme në vazhdim me anë të marrëveshjeve dypalëshe të zbatimit.

Neni 15

Dorëzimi i kontrolluar

1. Me një kërkesë të paraqitur nga një Palë Kontraktuese, një Palë tjetër Kontraktuese mund të lejojë, nëse është e përshtatshme, dorëzimin e kontrolluar në territorin e saj në rast të zhvillimit të

hetimeve për vepra penale për të cilat personat që i kryejnë ato ekstradohen, sidomos transportin e substancave narkotike, prekursorëve, armëve të zjarrit, eksplozivëve, kartëmonedhave të falsifikuara dhe sendeve që e kanë origjinën nga një krim ose synohet që të përdoren për kryerjen e një krimi, në qoftë se Pala Kontraktuese që paraqet kërkesën jep shpjegime se pa një masë të tillë identifikimi i kriminelëve ose i rrugëve të shpërndarjes do të ishte i pamundur ose do të pengohej në një shkallë të madhe. Nëse përmbajtja e një dorëzimi të kontrolluar paraqet një rrezik të veçantë për personat e përfshirë ose një rrezik për publikun, Pala Kontraktuese që drejton kërkesën ka të drejtë të kërkojë që të plotësohen kushte të caktuara përpara se të aprovojë ose ta refuzojë të gjithë kërkesën.

2. Pala Kontraktuese që merr kërkesën do të marrë nën kontroll ngarkesën pasi ajo kalon kufirin, ose në një vend të caktuar për dorëzimin, për të cilin është rënë dakord nga autoritetet e zbatimit të ligjit, me qëllim që të shmanget ndërprerja e kontrollit dhe të garantojë survejim të vazhdueshëm të transportit të ngarkesës në një mënyrë të tillë që mundëson ndërhyrjen e policisë në çdo kohë. Pas marrjes në dorëzim nga Pala Kontraktuese që ka marrë kërkesën, punonjës policie nga Pala Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën mund të vazhdojnë të ndjekin dorëzimin e kontrolluar së bashku me punonjësin e policisë të Palës Kontraktuese që ka marrë kërkesën në bazë të marrëveshjes me këtë Palë Kontraktuese.

3. Punonjësit e policisë të Palës Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën janë të detyruar që të zbatojnë ligjet e Palës Kontraktuese që ka marrë kërkesën.

4. Në rast se autoritetet kompetente të zbatimit të ligjit të Palës Kontraktuese që ka marrë kërkesën nuk mund të ndërhyjnë në kohë dhe nëse vazhdimi i dorëzimit të kontrolluar mund të paraqesë një rrezik serioz për jetën ose shëndetin e personave, ose të shkaktojë dëmtime të rënda të pronës, ose në rast se dorëzimi nuk mund të mbahet më nën kontroll, punonjësit e policisë nga Pala Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën mund të sekuestrojë ngarkesën e dorëzimit të kontrolluar. Nëse është e nevojshme, punonjësit e policisë nga Pala Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën mund ta ndërpresin operacionin dhe të arrestojnë personat që shoqërojnë ngarkesën deri sa të ndërhyjnë autoritetet e zbatimit të ligjit nga Pala Kontraktuese që ka marrë kërkesën. Në çdo rast Pala Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën duhet të informojë pa vonesë autoritetet e zbatimit të ligjit të Palës Kontraktuese që ka marrë kërkesën.

5. Në rastet kur ngarkesa e dorëzimit të kontrolluar është sekuestruar në territorin e Palës Kontraktuese që ka marrë kërkesën, ajo mund t'i dorëzohet Palës Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën mbi bazën e një kërkese.

6. Një person, cilado qoftë shtetësia e tij, i cili është arrestuar nga autoritetet lokale kompetente, në vijim të veprimit të parashikuar në paragrafin 3, mund të mbahet për t'u marrë në pyetje. Rregullat përkatëse të ligjit kombëtar do të zbatohen rast pas rasti.

7. Në qoftë se personi nuk është një shtetas i Palës Kontraktuese në territorin e së cilës është arrestuar, ai person duhet të lirohet jo më vonë se gjashtë orë pas arrestimit, duke mos përfshirë orët ndërmjet mesnatës dhe orës 9.^{00} të mëngjesit, në qoftë se autoritetet lokale kompetente nuk kanë marrë më përpara një kërkesë për arrestimin e përkohshëm të atij personi me qëllim të ekstradimit të tij në njërën nga mënyrat e mundshme.

8. Gjatë një dorëzimi të kontrolluar, duhet të zbatohen përkatësisht dispozitat e nenit 14, paragrafi 4, germa a) deri në c) dhe germa e) deri në h) për punonjësit e policisë të Palës Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën.

9. Një kërkesë zyrtare me shkrim që kërkon aplikimin e një dorëzimi të kontrolluar, për të cilin kontrolli fillon ose vazhdon në një shtet të tretë, duhet të aprovohet vetëm në rast se kërkesa e bën të qartë që kushtet e përcaktuara në paragrafin 2 janë plotësuar gjithashtu edhe nga shteti i tretë.

Neni 16

Hetimet e fshehta për të hetuar krimet

1. Gjatë hetimeve të veprave penale, një Palë Kontraktuese- mbi bazë të një kërkese të marrë paraprakisht mund të bjerë dakord për dislokimin e punonjësve të policisë nga Pala Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën sipas kushteve të legjislacionit të saj, të cilët mund të luajnë rolin e një agjenti ose të një personi që kryhen një blerje të kontrolluar (pas kësaj do të referohet si "punonjës policie nën mbulim"). Pala Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën duhet të paraqesë një kërkesë të tillë vetëm në

rast se hetimi i një vepre penale mund të jetë i pamundur duke përdorur mënyra të tjera ose do të pengohet në një shkallë të madhe. Nuk është e nevojshme që të zbulohet identiteti i vërtetë i punonjësit të policisë në kërkesën që paraqitet.

2. Hetimet e fshehta që kryhen në territorin e Palës Kontraktuese që ka marrë kërkesën duhet të kufizohen në operacione të përkohshme, të veçuara. Përgatitjet për këto operacione kryhen në bashkëpunim të ngushtë me punonjësit e policisë të Palëve Kontraktuese të përfshirë në këto operacione. Dislokimi i një punonjësi policie nën mbulim dhe ekzekutimi i veprimeve nga ana e tij duhet të menaxhohen nga ana e Palës Kontraktuese që merr kërkesën. Pala Kontraktuese që merr kërkesën mban përgjegjësi për veprimet që kryhen nga ana e punonjësit të policisë nga Pala Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën, i cili heton në fshehtësi, dhe mund të kërkojë në çdo kohë përfundimin e operacionit.

3. Dislokimi i punonjësve të policisë që hetojnë në fshehtësi sipas këtij neni, kushtet sipas të cilave kryhet operacioni dhe kushtet e përdorimit të rezultateve të hetimit janë në varësi të legjislacionit të asaj Pale Kontraktuese, në territorin e së cilës është dislokuar punonjësi i policisë nën mbulim.

4. Pala Kontraktuese që merr kërkesën i jep punonjësit të policisë nën mbulim të gjithë mbështetjen e nevojshme përsa i përket personelit, duke përfshirë praninë e instruktorit të tij, logjistikën dhe pajisjet teknike dhe merr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur punonjësin e policisë nën mbulim gjatë operacionit që kryhet në territorin e saj.

5. Në rast se për shkak të emergjencës ekstreme, ekziston një rrezik i madh që mund të zbulohet identiteti i punonjësit të policisë nën mbulim, dislokimi i një punonjësi të policisë nën mbulim në territorin e palës tjetër Kontraktuese duhet të lejohet pa miratim paraprak ashtu siç përcaktohet në paragrafin 1. Në raste të tilla duhet të plotësohen kushtet paraprake për dislokimin e punonjësit të policisë nën mbulim në territorin e Palës tjetër Kontraktuese. Aktivitetet e një agjenti të fshehtë duhet medoemos të kufizohen deri në atë masë që është e nevojshme për sigurinë e tij/të saj ose për të mbështetur vijën e tij/të saj të sjelljes. Pala Kontraktuese që merr kërkesën duhet të njoftohet pa vonesë mbi dislokimin dhe mund të kërkojë në çdo kohë përfundimin e operacionit.

6. Paragrafët 1 deri 4 do të zbatohen përkatësisht në rastet kur një Palë Kontraktuese kërkon dislokimin në territorin e saj të një punonjësi policie nën mbulim nga Pala tjetër Kontraktuese. Në raste të tilla, nëse nuk është rënë dakord për të kundërtën, Pala Kontraktuese që paraqet kërkesën mbulon kostot e operacionit.

7. Palët Kontraktuese duhet të marrin të gjitha masat parandaluese të nevojshme për ta mbajtur të fshehtë identitetin e punonjësit të policisë nën mbulim dhe të garantojnë sigurinë e tij/të saj edhe pasi të ketë përfunduar periudha e dislokimit të tij/të saj.

Neni 17

Hetimet e fshehta për parandalimin e veprave penale

1. Për aq sa është e lejueshme sipas legjislacionit përkatës kombëtar, hetimet e fshehta për parandalimin e veprave të rënda penale, për të cilat autorët ekstradohen, mund të kryhen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, nëse jepet miratimi për këtë hetim të fshehtë ndërkufitar mbi bazën e një kërkese që është marrë paraprakisht.

2. Neni 14 do të zbatohet përkatësisht.

Neni 18

Kërkesa për mbledhjen e provave në rast të rrezikut imediat

1. Në rast të rrezikut imediat, kërkesat mund të paraqiten nga autoritetet përkatëse të zbatimit të ligjit për aq sa janë të autorizuar për të vepruar në këtë mënyrë sipas ligjit kombëtar, për të mbledhur prova duke përfshirë ekzaminime fizike, si dhe kontrolle dhe sekuestrime, për aq sa parashikohet nga legjislacioni kombëtar. Kërkesat duhet t’i drejtohen drejtpërdrejt autoritetit kompetent të zbatimit të ligjit.

2. Ekzekutimi i kërkesës duke përfshirë vendimin nëse ekziston në të vërtetë një rrezik imediat varet nga ligji i Palës Kontraktuese që ka marrë kërkesën, e cila duhet të informojë pa vonesë për këtë vendim Palën Kontraktuese që ka drejtuar kërkesën.

3. Nëse kërkesa që referohet në paragrafin 1 nuk është bërë nga autoriteti gjyqësor, autoriteti gjyqësor i ngarkuar duhet të njoftohet pa vonesë që kërkesa është bërë duke përfshirë edhe rrethanat e veçanta të çështjes, duke nënkuptuar rrezikun imediat.

4. Duke qenë se ligji i Palës Kontraktuese që merr kërkesën kërkon një urdhër gjykate për të dhënë ose lënë në fuqi masën në territorin e Palës Kontraktuese që merr kërkesën, një urdhër ose shpjegim nga gjykata kompetente e Palës Kontraktuese që paraqet kërkesën duhet të depozitohet pa vonesë. Palët Kontraktuese duhet të informojnë njëra-tjetrën rreth dispozitave përkatëse të ligjit të tyre kombëtar.

5. Transmetimi i rezultateve të masave të marra për Palën Kontraktuese që paraqet kërkesën e bën të domosdoshme përpilimin e një letër porosie zyrtare nga autoriteti kompetent gjyqësor. Nëse rezultatet e masave të marra duhet të transmetohen si një nevojë e ngutshme, autoriteti që merr kërkesën mund të transmetojë rezultatet drejtpërdrejt tek autoriteti që paraqet kërkesën. Në rast se autoriteti që merr kërkesën nuk është një autoritet gjyqësor, transmetimi i rezultateve do të kërkojë miratim paraprak nga autoriteti kompetent gjyqësor.

Neni 19

Kërkesa për ekzaminim fizik

1. Për aq sa lejohet nga ligji i Palës Kontraktuese që merr kërkesën, autoritetet e zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese duhet t'i japin njëri-tjetrit asistencë të ndërsjellë lidhur me ekzaminimin fizik të personit të dyshuar dhe individëve të tjerë.

2. Kërkesat sipas paragrafit 1 do të aprovohen vetëm nëse:

a) ekzaminimi kërkohet për të përcaktuar faktet që kanë lidhje me çështjen dhe është në përputhje me rrezikshmërinë e veprës penale;

b) një urdhër për ekzaminim fizik dërgohet nga një shërbim i autorizuar për kryerjen e një ekzaminimi të tillë në bazë të ligjit kombëtar të Palës Kontraktuese që paraqet kërkesën, ose bëhet e qartë nga një mesazh i një shërbimi të tillë se janë plotësuar kushtet paraprake për një ekzaminim të tillë, në rast se personi i dyshuar ose persona të tjerë ndodhen në territorin e Palës Kontraktuese që paraqet kërkesën.

Neni 20

Transmetimi dhe krahasimi i profileve të ADN-së dhe materialeve të tjera identifikuese

1. Gjatë hetimeve ose proceseve të ndjekjeve penale të mbetura pezull dhe për të respektuar personat e humbur dhe trupat e paidentifikuar, shërbimet kompetente të Palëve Kontraktuese duhet të ofrojnë ndihmë reciproke duke shkëmbyer dhe kërkuar për profilet e ADN-së dhe materiale të tjera identifikuese në programet e tyre kompjuterike të të dhënave, ashtu si parashikohet në legjislacionet e tyre respektive kombëtare. Rezultatet e tyre duhet t'u bëhen të njohura sa më shpejt të jetë e mundur shërbimeve kompetente të Palës Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën. Për këtë qëllim duhet të përdoret formulari i INTERPOL-it për ADN-në në versionin që është i vlefshëm në kohën e përpilimit të kërkesës. Nëse del e nevojshme përcaktimi i kategorive të materialit biologjik për të rritur saktësinë e statistikave biologjike, Pala Kontraktuese që ka marrë kërkesën – për aq sa është e mundshme dhe e përshtatshme, mund të marrë masa për përcaktimin e kategorive të tilla të materialit biologjik. Të gjitha shpenzimet që rrjedhin nga një veprim i tillë duhet t'i kompensohen Palës Kontraktuese që ka marrë kërkesën.

2. Nëse kërkimi në programin e të dhënave të ADN-së, siç është përshkruar në paragrafin 1, ka dalë negativ, Pala Kontraktuese që ka marrë kërkesën duhet ta ruajë profilin e siguruar të ADN-së ashtu siç përcaktohet në paragrafin 1, me qëllim që të zhvillojë kërkime në programin e saj të të dhënave të ADN-së ashtu siç parashikohet nga ligji i saj kombëtar, nëse një veprim i tillë do t'i kërkohet nga Pala Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën.

3. Nëse nuk disponohet profili i ADN-së së një personi të caktuar që ndodhet në territorin e Palës Kontraktuese që ka marrë kërkesën, Pala Kontraktuese që ka marrë kërkesën duhet të ofrojë ndihmë juridike duke siguruar dhe analizuar materialin molekular-gjenetik të këtij personi dhe duke transmetuar profilet të ADN-së të përftuara nga analiza, në qoftë se:

a) Pala Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën e këshillon për të njëjtin qëllim;

b) Pala Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën i dërgon një kërkesë ose urdhër për analizë

shërbimit kompetent ashtu si parashikohet në ligjin e saj, duke vënë në dukje se ka arsye të justifikuara për grumbullimin dhe analizën e materialit molekular-gjenetik nëse personi do të qëndrojë në territorin e Palës Kontraktuese që ka paraqitur kërkesën; dhe

c) Janë plotësuar kushtet për sigurimin dhe analizën e materialit molekular-gjenetik sipas ligjit të Palës Kontraktuese që ka marrë kërkesën;

d) Pala Kontraktuese që ka marrë kërkesën duhet të rimbursohet për të gjitha kostot që rrjedhin nga një veprim i tillë.

4. Kërkesat mund të transmetohen gjithashtu edhe nga autoritetet kompetente policore të të dyja Palëve Kontraktuese dhe të trajtohen përmes kanaleve të njëjta.

Neni 21

Autoritetet përgjegjëse për kërkesat ashtu siç përcaktohet në kapitullin I

1. Autoritetet përkatëse të zbatimit të ligjit që janë përfshirë nga Palët Kontraktuese në listat e bashkëngjitura të referuara në nenin 37 duhet të jenë përgjegjëse për kërkesat që referohen në nenet 15, 16, 17, 18, 19 dhe 20.

2. Kopje të kërkesave që referohen në paragrafin 1 duhet të transmetohen në njësinë qendrore kombëtare të përshkruar në nenin 4 paragrafi 3.

Neni 22

Rregullimi i pozicionit ligjor të punonjësve të policisë që operojnë

Për qëllime të kësaj Konvente, punonjësit e policisë që operojnë në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese duhet të konsiderohen si punonjës policie të asaj pale në lidhje me veprat e kryera kundër tyre ose nga ana e tyre.

Neni 23

Përgjegjësia e punonjësve të policisë që operojnë

1. Aty ku, për qëllime të kësaj Konvente, punonjësit e policisë të një Pale Kontraktuese janë të angazhuar në operacione në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese, Pala e parë Kontraktuese duhet të mbajë përgjegjësi për çdo dëm të shkaktuar nga punonjësit e policisë gjatë operacioneve të tyre, sipas ligjit të Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ata po operojnë.

2. Pala Kontraktuese në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi i referuar në paragrafin 1 duhet ta riparojë ose kompensojë atë sipas kushteve që zbatohen për dëmin e shkaktuar nga punonjësit e saj të policisë.

3. Pala Kontraktuese, punonjësit e policisë të së cilës kanë shkaktuar dëmin ndaj një personi në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese, duhet të rimbursojë këtë të fundit në mënyrë të plotë për të gjitha shumat që duhet t’i paguajë viktimave ose personave të autorizuar në emër të tyre.

Neni 24

Masat teknike për të lehtësuar bashkëpunimin ndërkufitar

1. Në përputhje me marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare dhe duke marrë parasysh rrethanat lokale dhe mundësitë teknike, Palët Kontraktuese duhet të instalojnë linja telefoni, radioje dhe teleksi në zona të veçanta kufitare, si dhe lidhje të drejtpërdrejta për të lehtësuar bashkëpunimin policor, në mënyrë të veçantë për transmetimin në kohë të informacionit në interes të bashkëpunimit policor siç parashikohet në këtë Konventë.

2. Përveç këtyre masave afatshkurtra, ata do të marrin në konsideratë sidomos alternativat e mëposhtme:

a) shkëmbimin e pajisjeve ose dislokimin e oficerëve të kontaktit të pajisur me pajisje radioje të përshtatshme;

b) zgjerimi i brezave të frekuencave që përdoren në zonat kufitare;

c) vendosja e lidhjeve të përbashkëta për shërbimet e policisë që operojnë në këto zona të njëjta;

d) koordinimi i programeve të tyre për prokurimin e pajisjeve të ndërlidhjes me synim instalimin e sistemeve standarde dhe të ngjashme të ndërlidhjes.

3. Në përputhje me marrëveshjet dypalëshe, Palët Kontraktuese mund të marrin masa për përdorimin e përbashkët të llojeve të tjera të pajisjeve teknike dhe mjeteve të tjera, që disponohen nga një ose më shumë Palë Kontraktuese.

Neni 25
Kompanitë që sigurojnë strehim

1. Palët angazhohen të aprovojnë masat e nevojshme me qëllim që të sigurojnë që:

a) menaxherët e kompanive që sigurojnë strehim ose agjentët e tyre duhet të sigurohen që shtetasit e huaj të plotësojnë dhe të nënshkruajnë personalisht formularët e regjistrimit dhe të konfirmojnë identitetin e tyre, duke paraqitur një dokument të vlefshëm identifikimi;

b) formularët e plotësuar të regjistrimit do të mbahen për autoritetet e zbatimit të ligjit ose do t'i dërgohen atyre atje ku këto autoritete e konsiderojnë të nevojshme për parandalimin e kërcënimeve, për hetimet penale ose për sqarimin e rrethanave të personave të humbur ose viktimave të aksidenteve, me përjashtim të rasteve kur ligji kombëtar parashikon të kundërtën.

2. Paragrafi 1 duhet të aplikohet rast pas rasti për personat që qëndrojnë në çdo ambient të marrë me qira sipas kushteve tregtare, në mënyrë të veçantë në çadra, karvanë dhe varka.

Të huaj janë ata persona që nuk janë shtetas të Palës Kontraktuese ku është ofruar strehimi dhe është bërë regjistrimi.

KAPITULLI II
KUSHTET E BASHKËPUNIMIT

Neni 26
Operacionet e përbashkëta të kërkimit dhe bashkëpunimi në zonat ndërkufitare

1. Nëse lind nevoja, autoritetet e zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese duhet të formojnë grupe të përziera të analizës dhe grupe të tjera pune, si dhe skuadra për kontrollin dhe survejimin, në të cilat punonjësit e policisë të një Pale Kontraktuese marrin një rol mbështetës dhe këshillues, me qëllim që të intensifikojnë bashkëpunimin gjatë operacioneve në territorin e Palës tjetër Kontraktuese pa ushtruar kompetenca të plota në mënyrë të pavarur.

2. Autoritetet e zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese në rajonet kufitare, marrin pjesë në operacionet e kërkimit në zonat ndërkufitare për persona të dyshuar të larguar jashtë vendit. Njësitë Qendrore Kombëtare duhet të përfshihen në çështjet që kanë rëndësi që i kalon kufijtë e rajonit.

3. Autoritetet duhet të bashkëpunojnë në kërkimin e personave të humbur.

4. Kur punonjësit e policisë të një Pale Kontraktuese operojnë në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese, ata do të autorizohen që të mbajnë uniformat dhe armët e tyre të shërbimit dhe mjete të tjera për ushtrimin e forcës, me përjashtim të rasteve kur Pala tjetër Kontraktore në territorin e së cilës po zhvillohet operacioni, deklaron se një veprim i tillë nuk lejohet ose lejohet në rrethana të caktuara.

5. Përdorimi i armëve të shërbimit lejohet vetëm në rastin e vetëmbrojtjes.

Neni 27
Skuadra të përbashkëta të hetimit

1. Me anë të marrëveshjes bilaterale, autoritetet e zbatimit të ligjit të dy ose më shumë Palëve Kontraktuese mund të ngrenë një skuadër të përbashkët të hetimit për një qëllim të caktuar dhe për një periudhë kohe të caktuar, që mund të zgjatet nëpërmjet miratimit të të dyja palëve, për të zhvilluar hetime në territorin e një ose më shumë Palëve Kontraktuese ku është ngritur skuadra. Përbërja e skuadrës duhet të përcaktohet në marrëveshjen për ngritjen e skuadrës.

2. Një skuadër e përbashkët e hetimit në mënyrë të veçantë mund të ngrihet në ato raste kur:

a) Veprimet hetimore që kanë filluar nga një Palë Kontraktuese për vepra penale kërkojnë zhvillimin e hetimeve të vështira dhe komplekse që kanë lidhje me Palë të tjera Kontraktuese;

b) Një numër Palësh Kontraktuese po zhvillojnë hetime për vepra penale në të cilat rrethanat e çështjes kërkojnë veprime të koordinuara dhe të bashkërenduara nga Palët Kontraktuese që janë

përfshirë.

3. Një kërkesë për ngritjen e një skuadre të përbashkët të hetimit mund të drejtohet nga secila Palë Kontraktuese e interesuar. Skuadra duhet të ngrihet në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese ku shpresohet të zhvillohen hetimet.

4. Kërkesat për ngritjen e një skuadre të përbashkët të hetimit duhet të përfshijnë autoritetin që drejton kërkesën, qëllimin e skuadrës së përbashkët të hetimit, Palët Kontraktuese në territorin e të cilave skuadra e përbashkët e hetimit do të operojë dhe propozimet për përbërjen e skuadrës së përbashkët të hetimit.

5. Një skuadër e përbashkët e hetimit do të operojë në territorin e Palëve Kontraktuese që kanë ngritur skuadrën sipas kushteve të përgjithshme të mëposhtme:

a) drejtuesi i skuadrës që merr pjesë në hetimet penale duhet të jetë një përfaqësues i autoriteteve të zbatimit të ligjit nga Pala Kontraktuese në territorin e së cilës operon skuadra. Drejtuesi i skuadrës duhet të veprojë brenda kufijve të kompetencave të tij/të saj në përputhje me ligjin kombëtar;

b) skuadra duhet t'i kryejë operacionet në përputhje me ligjin e Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ajo operon. Pjesëtarët e skuadrës duhet t'i kryejnë detyrat e tyre nën drejtimin e personit të referuar në nënparagrafin (a) duke marrë parasysh kushtet e përcaktuara nga autoritetet e tyre në marrëveshjen për ngritjen e skuadrës.

6. Në këtë nen, anëtarë të skuadrës së përbashkët të hetimit nga Palët Kontraktuese të ndryshme nga Pala Kontraktuese në territorin e së cilës operon skuadra, referohen si "të komanduar" në skuadër.

7. Anëtarët e komanduar të skuadrës së përbashkët të hetimit duhet të jenë autorizuar që të jenë të pranishëm kur merren masat hetimore në territorin e Palës Kontraktuese ku zhvillohet operacioni. Sidoqoftë, drejtuesi i skuadrës, për arsye të veçanta, në përputhje me ligjin e Palës Kontraktuese ku operon skuadra, mund të vendosë për të kundërtën.

8. Në përputhje me ligjin e Palës Kontraktuese ku operon skuadra, anëtarët e komanduar të skuadrës së përbashkët të hetimit mund të ngarkohen nga drejtuesi i skuadrës me detyra për të ndërmarrë masa të caktuara hetimore në ato raste kur këto masa janë aprovuar nga autoritetet e zbatimit të ligjit të Palës Kontraktuese ku zhvillohet operacioni dhe të Palës Kontraktuese që ka dërguar punonjësit e policisë të komanduar.

9. Në ato raste kur skuadra e përbashkët e hetimit ka nevojë për marrjen e masave hetimore nga ana e njërës prej Palëve Kontraktuese që ka ngritur skuadrën, anëtarët e komanduar të skuadrës nga ajo Palë Kontraktuese mund t'i kërkojnë autoriteteve të tyre të zbatimit të ligjit që të marrin këto masa. Këto masa duhet të konsiderohen nga Pala Kontraktuese si të ngjashme me masat që merren gjatë një hetimi të zakonshëm që kryhet brenda territorit të saj.

10. Në ato raste kur skuadra e përbashkët e hetimit ka nevojë për asistencë nga një Palë Kontraktuese e ndryshme nga ato që kanë ngritur skuadrën, ose nga një shtet i tretë, kërkesa për asistencë mund të drejtohet nga autoritetet e zbatimit të ligjit të Palës Kontraktuese ku zhvillohet operacioni për autoritetet e zbatimit të ligjit të Palës tjetër Kontraktuese në përputhje me instrumentet ose marrëveshjet përkatëse.

11. Një anëtar i skuadrës së përbashkët të hetimit, në përputhje me ligjin e tij/të saj kombëtar dhe brenda kufijve të kompetencave të tij/të saj, mund t'i japë skuadrës informacion që disponohet nga Pala Kontraktuese që e ka komanduar atë me qëllim që të ndihmojë hetimet penale që zhvillohen nga skuadra.

12. Informacioni i siguruar në mënyrë të ligjshme nga një anëtar ose anëtar i komanduar ndërkohë që është pjesë e një skuadre të përbashkët të hetimit, që nuk disponohet në kushte të tjera nga autoritetet e zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese të interesuara, mund të përdoret për qëllimet e mëposhtme:

a) për qëllimet për të cilat është ngritur skuadra;

b) për zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave të tjera penale në varësi të miratimit paraprak nga ana e Palës Kontraktuese ku është siguruar informacioni. Një miratim i tillë mund të refuzohet vetëm në rastet kur një përdorim i tillë mund të rrezikonte hetimet penale të Palës Kontraktuese të interesuar ose kur ajo Palë Kontraktuese mund të refuzonte asistencën bilaterale në lidhje me të;

c) Për të parandaluar një kërcënim serioz dhe imediat për sigurinë publike dhe pa paragjykim

për nënparagrafin (b) nëse si rrjedhim i informacionit ka filluar një hetim penal;

d) Për qëllime të tjera deri në atë shkallë që bihet dakord ndërmjet Palëve Kontraktuese që kanë ngritur skuadrën.

13. Ky nen duhet të konsiderohet pa paragjykime për çdo dispozitë ose marrëveshje tjetër ekzistuese mbi ngritjen ose funksionimin e skuadrave të përbashkëta të hetimit.

14. Deri në atë shkallë që lejohet nga ligjet e Palëve Kontraktuese të interesuara ose dispozitat e çdo instrumenti ligjor të aplikueshëm ndërmjet tyre, mund të arrihen marrëveshje për persona të tjerë të ndryshëm nga përfaqësuesit e autoriteteve të zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese që kanë ngritur skuadrën e përbashkët të hetimit, për të marrë pjesë në aktivitetet e skuadrës. Persona të tillë mund të përfshijnë për shembull, zyrtarë nga organizatat ndërkombëtare të njohura nga Palët Kontraktuese. Të drejtat që kanë anëtarët ose anëtarët e komanduar të skuadrës në bazë të këtij neni nuk duhet t'i gëzojnë këta persona, në qoftë se në marrëveshje është deklaruar në mënyrë specifike për të kundërtën.

Neni 28

Patrulla të përziera përgjatë kufirit shtetëror

1. Autoritetet e zbatimit të ligjit e Palëve Kontraktuese mund të organizojnë patrulla të përziera përgjatë kufirit të përbashkët në përputhje me ligjin kombëtar me qëllim që të shmangin rreziqet për sigurinë publike dhe për të luftuar kundër aktiviteteve të paligjshme ndërkufitare.

2. Kur kryhen patrulla të përziera, punonjësit e policisë të Palës tjetër Kontraktuese duhet të autorizohen deri në atë masë që lejohet nga legjislacioni kombëtar i Palës Kontraktuese në territorin e së cilës ata po veprojnë, që të përcaktojnë identitetin e personave dhe t'i ndalojnë ata në rast se ata përpiqen t'i shmangen kontrollit. Masa të tjera duhet të merren nga punonjësit e policisë të Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës po kryhet operacioni, në qoftë se masat nuk do të jenë të efektshme ose nuk do të jetë e mundur të realizohen pa ndërhyrjen e punonjësve të policisë të Palës tjetër Kontraktuese.

3. Gjatë kryerjes së patrullave të përziera të referuara në paragrafët 1 dhe 2 do të zbatohet legjislacioni i asaj Pale Kontraktuese në territorin e së cilës punonjësit e policisë janë aktivë.

4. Kur punonjësit e policisë së një Pale Kontraktuese po operojnë në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese ata duhet të autorizohen të mbajnë uniformat dhe armët e tyre të shërbimit, si dhe mjete të tjera të përdorimit të forcës, me përjashtim të rasteve kur Pala tjetër Kontraktuese në territorin e së cilës po zhvillohet operacioni, do të deklarojë që një veprim i tillë nuk lejohet ose lejohet në rrethana të caktuara.

5. Përdorimi i armëve të shërbimit lejohet vetëm në rastet e vetëmbrojtjes.

Neni 29

Bashkëpunimi në qendra të përbashkëta

1. Qendra të përbashkëta mund të ngrihen për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve të zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese në kuadër të kësaj Konvente.

2. Në qendrat e përbashkëta punonjësit e policisë të Palëve Kontraktuese duhet të bashkëpunojnë përkrah njëri-tjetrit në kuadër të kompetencave të tyre respektive me qëllim që të shkëmbejnë, analizojnë dhe të transmetojnë informacion dhe të luajnë gjithashtu një rol mbështetës në koordinimin ose bashkëpunimin ndërkufitar, ashtu siç është përcaktuar në këtë Konventë pavarësisht nga kontaktet zyrtare, korrespondencës dhe shkëmbimit të informacionit nëpërmjet njësive qendrore kombëtare. Nenet 3 dhe 4 të Konventës duhet të zbatohen përkatësisht për transmetimin e të dhënave të personave ndërmjet punonjësve të policisë dhe dispozitat e nenit 30 të konventës do të zbatohen të plota.

3. Aktivitetet mbështetëse mund të përfshijnë gjithashtu përgatitjen dhe asistencën në dorëzimin e personave sipas marrëveshjeve të arritura ndërmjet Palëve Kontraktuese.

4. Punonjësit e policisë që bashkëpunojnë në qendrat e përbashkëta duhet t'i nënshtrohen vetëm udhëzimeve dhe kompetencave disiplinore të autoriteteve të tyre kombëtare. Punonjësit e

policisë në qendrat e përbashkëta nuk duhet të kryejnë aktivitete operacionale në mënyrë të pavarur. Operacione të përbashkëta mund të kryhen vetëm në bazë të marrëveshjes ndërmjet autoriteteve kompetente të zbatimit të ligjit të Palëve Kontraktuese dhe sipas mënyrave të mundshme në bazë të kësaj Konvente.

5. Ngritja e qendrave të përbashkëta, përcaktimi i modaliteteve të bashkëpunimit dhe madje edhe shpërndarja e kostove duhet të rregullohet në marrëveshjet e zbatimit të specifikuara në nenin 34 paragrafi 1.

Neni 30
Kufizimi i bashkëpunimit

1. Në rast se një Palë Kontraktuese është e mendimit që aprovimi për ekzekutimin e një kërkese ose të ndonjë forme tjetër të bashkëpunimit mund të rrezikojë sigurinë e saj ose interesa të tjera të rëndësishme, ose legjislacionin kombëtar, ajo duhet të informojë Palën tjetër Kontraktuese që ajo e refuzon bashkëpunimin në mënyrë të plotë ose të pjesshme, ose është dakord të bashkëpunojë duke vendosur kushte të caktuara. Palët Kontraktuese duhet të informojnë me shkrim njëra-tjetrën pa vonesë duke përmendur arsyen për refuzimin e plotë ose të pjesshëm të bashkëpunimit.

2. Pajisjet teknike dhe dokumentacioni teknik përkatës që i jepet autoriteteve të zbatimit të ligjit sipas kësaj Konvente nuk duhet t'i jepet në asnjë mënyrë palëve të treta pa miratimin paraprak të autoriteteve që i ofrojnë ato.

Neni 31
Mbrojtja e të dhënave

1. Në lidhje me përpunimin në mënyrë automatike të të dhënave personale që komunikohen në përputhje me këtë Konventë, secila Palë Kontraktuese duhet të aprovojë, jo më vonë se sa data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, dispozitat e nevojshme kombëtare me qëllim që të arrijë një nivel të mbrojtjes së të dhënave që është në përputhje me parimet e Rekomandimit Nr. R (87) 15 të 17 shtatorit 1987 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës që rregullon përdorimin e të dhënave personale në sektorin e policisë.

2. Për më tepër, duhet medoemos të arrihet një nivel i mbrojtjes së të dhënave personale, së paku i njëjtë me atë që rezulton nga Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Individëve e 28 janarit 1981, në lidhje me përpunimin në mënyrë automatike të të dhënave personale.

3. Komunikimi i të dhënave personale i parashikuar në këtë Konventë nuk mund të kryhet deri sa dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, ashtu si është specifikuar në paragrafin 1, të hyjnë në fuqi në territoret e Palëve Kontraktuese të përfshira në këtë komunikim.

4. Dispozitat e mëposhtme duhet të zbatohen për transmetimin e të dhënave sipas kushteve të kapitullit I dhe II të kësaj Konvente si dhe për përdorimin dhe përpunimin e tyre të mëtejshëm:

a) Të dhënat e komunikuara sipas kësaj Konvente duhet të përdoren nga Palët Kontraktuese vetëm për qëllime për të cilat ato janë transmetuar ose për të parandaluar një kërcënim serioz dhe imediat për sigurinë publike ose për të parandaluar një vepër të rëndë penale. Përpunimi për qëllime të tjera duhet të lejohet vetëm me autorizim paraprak të Palës Kontraktuese që bën komunikimin.

b) Kur transmeton të dhëna, autoriteti transmetues duhet të vendosë afate për fshirjen dhe/ose shkatërrimin (që këtej e tutje referohet si "shkatërrimi") i të dhënave në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar. Pavarësisht nga këto afate, të dhënat e transmetuara duhet të shkatërrohen në rast se nuk kërkohen më për realizimin e detyrave, që përbëjnë arsyen për transmetimin e tyre, ose për ndonjë qëllim tjetër në përputhje me nënparagrafin a). Afati i fundit për shkatërrimin e të dhënave të transmetuara duhet të jetë dita e përfundimit të vlefshmërisë së kësaj Konvente, në qoftë se ajo nuk zëvendësohet me një Konventë të re.

c) Në qoftë se rezulton se janë transmetuar të dhëna të pasakta, ose të siguruara në mënyrë të paligjshme, autoriteti transmetues duhet të jetë i detyruar të informojë në mënyrën e duhur dhe pa vonesë autoritetin marrës. Marrësi duhet të shkatërrojë pa vonesë të dhënat e paligjshme të siguruara ose të transmetuara ose të korrigjojë të dhënat e pasakta. Nëse marrësi informohet për përpunimin e paligjshëm të të dhënave të transmetuara, ai duhet të jetë i detyruar që të njoftojë autoritetin transmetues në mënyrën e duhur dhe pa vonesë. Nëse marrësi ka arsye të besojë se të dhënat e

transmetuara janë të pasakta, ose që ato duhet të shkatërrohen, ai do të njoftojë në mënyrën e duhur dhe pa vonesë autoritetin transmetues. Autoriteti transmetues dhe marrësi duhet të informojnë njëri-tjetrin mbi të gjitha rrethanat që kanë rëndësi për mbajtjen me saktësi dhe azhurnimin e të dhënave të transmetuara.

d) Marrësi është i detyruar që të mbrojë në mënyrë të efektshme të dhënat e transmetuara nga shkatërrimi i paautorizuar ose aksidental, humbja aksidentale ose ndryshimi aksidental ose i paautorizuar, shpërndarja aksidentale ose e paautorizuar, përdorimi aksidental ose i paautorizuar, ose botimi aksidental ose i paautorizuar.

e) Autoriteti transmetues dhe marrësi duhet të jenë të detyruar të mbajnë regjistra-dosje të transmetimit, marrjes dhe shkatërrimit të të dhënave. Regjistrimi përfshin arsyen e dërgimit, përmbajtjen, autoritetin transmetues dhe marrësin, kohën e transmetimit dhe të shkatërrimit të të dhënave. Të dhënat që transmetohen me anë të kompjuterëve duhet të regjistrohen me anë të metodave kompjuterike. Të dhënat e regjistruara duhet të mbahen për një periudhë minimale prej tre vjetësh. Të dhënat e regjistruara mund të përdoren për të kontrolluar nëse janë respektuar dispozitat ligjore lidhur me mbrojtjen e të dhënave.

f) Marrësi duhet të informojë autoritetin transmetues në bazë të kërkesës për çdo përpunim të të dhënave të transmetuara, si dhe për rezultatet e siguruara nga ky proces.

g) Çdo person duhet të jetë i autorizuar në bazë të kërkesës që të marrë informacion nga autoriteti përgjegjës për përpunimin e të dhënave në lidhje me të, që janë transmetuar ose përpunuar në kuadër të kësaj Konvente dhe duhet të jetë i autorizuar që të korrigjojë të dhënat e pasakta ose të shkatërrojë të dhënat e përpunuara në mënyrë të paligjshme. Përjashtime nga ky rregull dhe procesi praktik varen nga ligji kombëtar i asaj Pale Kontraktuese, së cilës i është kërkuar informacion, korrigjim ose shkatërrimi i të dhënave. Përpara se të merret një vendim në lidhje me një kërkesë të tillë, marrësi duhet t’i japë autoritetit transmetues një mundësi për të paraqitur komente.

h) Palët Kontraktuese duhet të sigurojnë që çdo person në rast të shkeljes së të drejtave për mbrojtjen e të dhënave të tij/saj, mund të ankohet tek një gjykatë e pavarur ose tek një autoritet i pavarur kompetent dhe ai/ajo mund të kërkojë dëmshpërblim.

i) Informacioni i marrë nga Palët Kontraktuese duhet të transmetohet më tej për shtetet e treta vetëm me autorizim paraprak të Palës Kontraktuese që e ka siguruar informacionin.

5. Palët Kontraktuese duhet të mbajnë përgjegjësi në përputhje me legjislacionin e tyre përkatës për dëme të shkaktuara ndaj një personi si rrjedhim i përpunimit të të dhënave në lidhje me të që janë transmetuar në kuadër të kësaj Konvente në rastet kur të dhënat e transmetuara kanë qenë të pasakta ose janë transmetuar në mënyrë të paligjshme. Nëse janë përgjegjëse në bazë të legjislacionit të tyre, Palët Kontraktuese nuk mund të deklarojnë përballë personit të paragjykuar që të dhënat e transmetuara janë transmetuar në mënyrë të pasaktë ose të paligjshme nga një Palë tjetër Kontraktuese. Nëse Pala Kontraktuese marrëse dëmshpërblen një dëm të shkaktuar nga përdorimi i të dhënave të transmetuara në mënyrë të pasaktë ose të paligjshme, Pala Kontraktuese që transmeton të dhënat do të rimbursojë të gjithë shumën e rimbursimit të dhënë.

6. Kontrolli për zbatimin e dispozitave ligjore mbi mbrojtjen e të dhënave kur përpunohen të dhënat e siguruara nga punonjësit aktivë të policisë në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese në kuadër të zbatimit të Konventës, është i detyrueshëm për autoritetin kompetent të asaj Pale Kontraktuese, në emër të së cilës janë siguruar të dhënat dhe që i nënshtrohen legjislacionit të saj.

7. Punonjësit e policisë që janë aktivë në territorin e një Pale tjetër Kontraktuese nuk duhet të kenë të drejtë për të hyrë dhe përdorur në mënyrë të drejtpërdrejtë të dhënat kompjuterike të kësaj Pale Kontraktuese.

Neni 32

Fshehtësia e informacionit dhe informacioni i klasifikuar

1. Palët Kontraktuese duhet të sigurojnë në parim një nivel mbrojtjeje bazë për të gjithë informacionin e marrë nga një Palë tjetër Kontraktuese, duke marrë të gjitha masat e nevojshme, përfshirë edhe detyrimin për të treguar maturi dhe ruajtur fshehtësinë, kufizimin e së drejtës për t’u njohur me informacionin vetëm për personelin e autorizuar, mbrojtjen e të dhënave personale dhe masave të përgjithshme teknike dhe procedurale për sigurisë e informacionit.

2. Informacioni i nënshtruar një niveli klasifikimi zyrtar të Palës Kontraktuese që transmeton,

i cili është shënuar si i tillë me një shenjë të veçantë, duhet t'i nënshtrohet të njëjtit nivel mbrojtjeje nga Pala Kontraktuese marrëse e informacionit në përputhje me tabelën e ekuivalencës së niveleve të klasifikimit të Palëve Kontraktuese në listat e bashkëngjitura në këtë Konventë.

3. Në përzgjedhjen e nivelit të klasifikimit, secila Palë Kontraktuese duhet të veprojë në përputhje me klasifikimin e informacionit sipas ligjit kombëtar ose rregulloreve që zbatohen dhe të marrë në konsideratë nevojën për fleksibilitet dhe kërkesën që klasifikimi i informacionit për autoritetet e zbatimit të ligjit përbën përjashtim dhe nëse një informacion i tillë duhet të klasifikohet, duhet të caktohet niveli më i ulët i mundshëm.

4. Autoriteti transmetues duhet të informojë marrësin me shkrim pa vonesë mbi ndonjë ndryshim të nivelit të klasifikimit ose për heqjen e niveleve të klasifikimit. Marrësi duhet të marrë përsipër të përshtatë nivelin e klasifikimit në përputhje me këtë mesazh ose të heqë nivelet e klasifikimit.

5. Informacioni i klasifikuar i transmetuar mund të përdoret vetëm për qëllimin për të cilin është transmetuar dhe duhet të vihet në dispozicion vetëm të atyre personave që e kërkojnë këtë informacion për aktivitetin e tyre dhe që janë të autorizuar në përputhje me ligjin kombëtar që të vihen në dijeni të informacionit të tillë të klasifikuar.

6. Të gjitha shkeljet e dispozitave ligjore nga ana e Palës Kontraktuese marrëse në lidhje me mbrojtjen e informacionit të klasifikuar që transmetohet duhet t'i bëhen me dije pa vonesë autoritetit transmetues. Ky komunikim duhet të përmbajë gjithashtu rrethanat dhe pasojat e një shkeljeje të tillë, si dhe masat e marra për të kufizuar pasojat dhe për të parandaluar shkelje të kësaj natyre në të ardhmen.

7. Informacioni i klasifikuar duhet të transmetohet te një Palë tjetër Kontraktuese me korrier ose me ndonjë mënyrë tjetër të aprovuar, e cila është e lejueshme sipas legjislacionit kombëtar të Palëve Kontraktuese.

KAPITULLI III
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 33
Komiteti i Ministrave

1. Duhet të ngrihet një Komitet i përbërë nga ministrat kompetentë të Palëve Kontraktuese. Komiteti i Ministrave vendos në mënyrë unanime për interpretimin, aprovimin dhe zbatimin e kësaj Konvente.

2. Palët Kontraktuese duhet të ngrenë një grup pune ekspertësh, i cili do të mbikëqyrë aprovimin dhe zbatimin e Konventës, të japë rekomandime për Komitetin e Ministrave për interpretimin dhe përmirësimin e dispozitave të Konventës dhe të kryejë aktivitete të tjera për nevojat e Komitetit.

3. Komiteti i Ministrave duhet të mblidhet me kërkesën e një Pale Kontraktuese, por të paktën një herë në vit. Ai do të mblidhet sipas radhës në territorin e secilës Palë Kontraktuese.

Neni 34
Marrëveshjet e zbatimit dhe komunikimet

1. Autoritetet qendrore kompetente të Palëve Kontraktuese mund të arrijnë marrëveshje zbatimi sipas kushteve të kësaj Konvente.

2. Palët Kontraktuese duhet të informojnë institucionin depozitues mbi ndryshimet në legjislacionet dhe emërtimet e autoriteteve të përmendura në tekstin e kësaj Konvente dhe në listat e bashkëngjitura.

Neni 35
Shpenzimet

Secila Palë Kontraktuese duhet të mbulojë kostot që dalin për autoritetet e saj nga zbatimi i kësaj Konvente në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar, në qoftë se nuk përmendet ndryshe në

këtë Konventë ose në marrëveshjet e zbatimit, ose nëse autoritetet e zbatimit të ligjit kanë rënë dakord më përpara për të kundërtën.

Neni 36
Marrëdhëniet e Konventës me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

Kjo Konventë nuk do të ndikojë mbi të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare.

Neni 37
Listat e bashkëngjitura

Listat e bashkëngjitura janë pjesë përbërëse e kësaj Konvente.

Neni 38
Institucioni për depozitimin e Konventës

1. Institucioni për depozitimin e kësaj Konvente është Republika e Shqipërisë.
2. Institucioni ku depozitohet Konventa duhet të njoftojë Palët e tjera Kontraktuese mbi depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, aprovimi ose hyrje, për çdo rezervë dhe deklaratë si dhe për të gjitha njoftimet e tjera të bëra në lidhje me këtë Konventë.
3. Institucioni ku depozitohet Konventa duhet të njoftojë të gjitha Palët Kontraktuese për të gjitha datat e hyrjes në fuqi të Konventës në përputhje me nenin 40.
4. Institucioni ku depozitohet Konventa duhet të marrë masat për regjistrimin e kësaj Konvente, me hyrjen e saj në fuqi, në Sekretariatin e Kombeve të Bashkuara në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.
5. Takimi i parë i Komitetit të Ministrave duhet të organizohet nga vendi ku depozitohet Konventa pas hyrjes në fuqi të Konventës.

Neni 39
Ratifikimi, pranimi, aprovimi ose hyrja

1. Kjo Konventë duhet t’i nënshtrohet procesit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit nga palët nënshkruese. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit duhet të depozitohen pranë institucionit ku depozitohet Konventa.
2. Kjo Konventë është e hapur për palët që dëshirojnë të bëhen pjesë e saj. Instrumenti i hyrjes duhet të depozitohet në institucionin ku depozitohet Konventa.

Neni 40
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi 90 ditë mbas depozitimit të dokumentit të dytë të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose të hyrjes.
2. Për çdo shtet që e ratifikon, pranon, aprovon ose që futet në këtë Konventë pas depozitimit të instrumentit të dytë të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes, Konventa do të hyjë në fuqi në ditën e nëntëdhjetë pas depozitimit nga ky shtet të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes.
3. Të gjitha marrëveshjet e zbatimit të arritura sipas kushteve të nenit 34 të kësaj Konvente duhet të bëhen të detyrueshme pas hyrjes në fuqi së kësaj Konvente për çdo shtet që e ratifikon, pranon, aprovon, ose hyn në këtë Konventë në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për këtë shtet.

Neni 41
Rezervat

1. Çdo shtet mund të formulojë rezerva në momentin e ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes.

2. Rezervat mund të tërhiqen në çdo kohë duke njoftuar institucionin ku depozitohet Konventa. Një njoftim i tillë do të ketë efekt nga data kur është marrë.

Neni 42

Tërheqja dhe pezullimi

1. Kjo Konventë duhet të përfundohet për një periudhë kohe të pacaktuar.

2. Secila Palë Kontraktuese mund të tërhiqet nga kjo Konventë në çdo kohë duke njoftuar me shkrim institucionin ku depozitohet Konventa. Tërheqja do të hyjë në fuqi gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga institucioni ku depozitohet Konventa.

3. Secila Palë Kontraktuese mund të pezullojë zbatimin e kësaj Konvente në mënyrë të plotë ose të pjesshme nëse është e nevojshme për të ruajtur sigurinë e shtetit, rendin ose sigurinë publike, ose jetën e personave. Palët Kontraktuese duhet të njoftojnë pa vonesë institucionin ku depozitohet Konventa mbi marrjen ose revokimin e një mase të tillë. Çdo masë e marrë sipas këtij paragrafi do të ketë efekt 15 ditë pas marrjes së një njoftimi të tillë nga institucioni ku depozitohet Konventa.

Personat nënshkrues, duke qenë të pranishëm dhe të autorizuar sipas rregullave nga qeveritë përkatëse, kanë firmosur këtë Konventë:

- Për Republikën e Shqipërisë:
- Për Bonjë dhe Hercegovinën:
- Për Republikën e Maqedonisë:
- Për Republikën e Moldavisë:
- Për Rumaninë:
- Për Republikën e Serbisë:
- Për Republikën e Malit të Zi:

E nënshkruar në ……., në datë....., në një variant origjinal në gjuhën angleze.

LISTAT E BASHKËNGJITURA

Neni 4 (2) (Autoritetet e zbatimit të ligjit)

Republika e Shqipërisë: Ministria e Brendshme

Bosnja dhe Hercegovina: Ministria e Sigurisë, ZQK e Interpolit në Sarajevë, Trg Bosnjë Hercegovinë 1 Sarajevë, 71000.

Republika e Moldavisë: Ministria e Brendshme

Republika e Maqedonisë: Ministria e Punëve të Brendshme

Rumania: Ministria e Brendshme dhe e Administratës

Republika e Serbisë: Ministria e Brendshme e Republikës së Serbisë

Republika e Malit të Zi: Drejtoria e Policisë

Neni 4 (3) (Njësitë qendrore kombëtare)

Kërkesat dhe përgjigjet ndaj kërkesave të rregulluara në nenin 4 të Konventës duhet të transmetohen te njësitë qendrore Kombëtare. “Njësitë Qendrore Kombëtare“ janë:

Për Republikën e Shqipërisë: Ministria e Brendshme

Për Bosnjën dhe Hercegovinën: Ministria e Sigurisë

Për Republikën e Maqedonisë: Ministria e Brendshme

Për Republikën e Moldavisë: Ministria e Punëve të Brendshme

Për Rumaninë: Ministria e Brendshme dhe e Administratës

Për Republikën e Serbisë: Ministria e Brendshme

Për Republikën e Malit të Zi: Drejtoria e Policisë

Neni 4 (4) (strukturat ekzistuese)

Për Republikën e Shqipërisë: Ministria e Brendshme
Për Bosnjën dhe Hercegovinën: Ministria e Sigurisë
Për Republikën e Maqedonisë: Ministria e Brendshme
Për Republikën e Moldavisë: Ministria e Punëve të Brendshme
Për Rumaninë: Ministria e Brendshme dhe e Administratës
Për Republikën e Serbisë: Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Drejtoria e Zjarrfikëseve
Për Republikën e Malit të Zi: Drejtoria e Policisë

Neni 32
Nivelet e klasifikimit

Niveli	Shqipëria	Bosnja & Hercegovina	Maqedonia	Moldavia	Mali i Zi	Rumania	Serbia
I kufizuar	-------	Interno	Internal	De serviciu/ service	Restricted	Secret de serviciu	Internal
Konfidencial	Konfidencial	Povjerljivo	Confidential	Confidential/ Confidential	Confidential	Secret	Service secret/ Confidental
Sekret	Sekret	Tajno	Top secret	Secret / Secret	Secret	Strict secret	Service secret / top secret
Tepër sekret	Tepër sekret	Vrlo tajno	State secret	Strict secret/ top secret	Top secret	Strict secret de importanta deosebita	State secret